

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “PËRMIRËSIME, RIORGANIZIME, INTEGRIME E ZHVILLIME TË REJA TË PLATFORMËS ZYRTARE NË INSTITUCION”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV): 7242100-7

- I. VLERA E FONDIT LIMIT: **7,488,277 (shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë)** " i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:
1. “Përmirësime, riorganizime, integritime e zhvillime të reja të platformës zyrtare në Institucion” në programin buxhetor “Investim (231)” me vlerë të fondit limit 6.875.000 (gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH .
 2. “Përmirësime, riorganizime, integritime e zhvillime të reja të platformës zyrtare në Institucion” në programin buxhetor “Shpenzime operative (602)” me vlerë të fondit limit 613.277 (gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
-

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1
- d. Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me

përylashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020, 2021 ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës përkatësisht 2,995,310 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e dhjetë lekë pa tvsh. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë:

.... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara....

Si dhe neni 55/4.....” Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41, pika 3 dhe neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) ISO 9001, ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;
- b) ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit;
- c) ISO 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit;

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën/çertifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi 2.3.2/a/b/c: Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

- a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;
- b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;
- c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe

cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;

- ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b) ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit;

- Standardi ISO 20000-1 ose ekuivalente përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit. Pra ISO 20000-1 ose ekuivalente është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës dhe mirëmbajtjes për 24 (njëzet e katër) muaj, sipas kërkesave të DST-së. Kjo certifikatë siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet IT që do të realizohen, do të menaxhohen sipas standardeve me të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e kontratës.

c) ISO 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit;

- ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :
 - mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës

së operatorit ekonomik.

- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, realizimi i përmirësimeve, integriteteve, zhvillimeve të reja, përditësimi i teknologjive të përdorura në versionin e fundit të rekomanduar nga prodhuesi., si mirëmbajtja e platformës për një periudhë 24 muaj, kërkon ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese si dhe në informacione sensitive të Bashkisë Tiranë, si rrjedhojë certifikimi ISO 27001 i operatorit ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, trajtimin e të dhënave dhe shërbimeve që do të kryhen.

Kërkesa për ISO 27001 është një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjës, i certifikuar për ITIL ose ekuivalente.
- b) 1 (një) punonjës me të paktën 1 (një) vit eksperiencë, të certifikuar për Web Applications ose ekuivalente.
- c) 1 (një) punonjës me të paktën 1 (një) vit eksperiencë, të certifikuar në programim (HTML5/CSS3/JS) ose ekuivalente.
- d) 1 (një) punonjës me të paktën 1 (një) vit experiencë, të certifikuar në gjuhën e programimit C# në .NET ose java ose ekuivalente.
- e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për siguri informacioni.
- f) Të paktën 1 (një) punonjës, të certifikuar për databazë.

Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;
- CV
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Kriteri 2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- a) 1 (një) punonjës, i certifikuar për ITIL ose ekuivalente.

Argumentim: Një çertifikim ITIL është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kërkesa për çertifikim ITIL ose ekuivalente, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të çertifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të kontratës në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes. Kjo kërkesë përforcon kërkesën për çertifikim ISO 20000, auditimet periodike për ricertifikimin e të cilit, duke qenë se bëhen mbi baza vjetore nuk garantojnë apriori që operatori ekonomik ka në përbërjen aktuale të stafit të tij personel të kualifikuar që ndjek dhe mbikqyr projektet në nivel operacional bazuar mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të menaxhimit të shërbimeve IT.

b) 1 (një) punonjës me të paktën 1 (një) vit eksperiencë, të certifikuar për Web Applications ose ekuivalente.

Argumentim: Certifikimi për Web Applications, është një certifikim i cili dëshmon dhe garanton mbi aftësitë e nevojshme për krijimin dhe zhvillimin e aplikacioneve dhe shërbimeve moderne në internet.

Platforma për të cilën kërkohen zhvillime/përditësime si dhe mirëmbajtje e vazhdueshme sipas marrëveshjes SLA të përcaktuar nga AK, ofrohet web based dhe për të realizuar objektivat e kontratës nevojitet që operatori ekonomik të ketë zhvillues të certifikuar për Web Applications ose ekuivalente. Referuar termave të referencës së procedurës së prokurimit, natyrës dhe objektit të saj, shërbimeve të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, detyrat specifike të ofruesit të shërbimit, rëndësisë që ka platforma zyrtare për informacionin që ofron për komunitetin e Bashkisë Tiranë, dhe për të garantuar AK për zbatimin e kontratës në kohë dhe me cilësi, shfaqet e nevojshme zotërimi i stafit zhvillues me ekperiencë të paktën 1 (një) vit të certifikuar për Web Applications ose ekuivalente.

Kërkesa për staf të certifikuar si zhvillues për Web Applications ose ekuivalente garanton autoritetin kontraktor për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar, objekt i kontratës dhe vërteton që operatori ekonomik zotëron staf me njohuritë themelore dhe aftësitë e dëshmuara në fushën e zhvillimeve Web Application ose ekuivalente.

c) 1 (një) punonjës me të paktën 1 (një) vit eksperiencë, të certifikuar në programim (HTML5/CSS3/JS) ose ekuivalente.

Argumentim: Një punonjës i certifikuar për programim (HTML5/CSS3/JS) ose ekuivalente ka dijet e nevojshme për të programuar ndërfaqe web i cili përmbush standardet minimale dhe profesionale për të implementuar ndryshimet e kërkuara sipas nevojave të autoritetit, objekt kontrate.

Kërkesa për staf të certifikuar për programim web (HTML5/CSS3/JS)/ekuivalente, gjykojmë se është e bazuar dhe e lidhur ngushtësisht me realizimin e përmirësimeve të kërkuara për të përmbushur të gjitha funksionalitetet dhe kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht me zërat:

...“

- Modifikimi dhe përmirësimi i moduleve, funksionaliteteve sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Riorganizime të menuve, nënmenuve.

...”

d) 1 (një) punonjës me të paktën 1 (një) vit experiencë, të certifikuar në gjuhën e programimit C# në .NET ose java ose ekuivalente.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Një punonjës i certifikuar për C# në .NET ose java/ ekuivalente është i aftë për të programuar në teknologjitë me të cilën është ndërtuar platforma ose ekuivalente me to, duke përmbushur standardet minimale dhe profesionale për të mundur zhvillimet e kërkuara dhe kontratën në tërësi sipas kërkesave të përcaktuara në termat e referencës bashkëlidhur.

e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për siguri informacioni.

Argumentim: Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të vërtetojë që punonjësi me certifikimin në sigurinë e informacionit, pjesë e stafit teknik të operatorit ekonomik, ka aftësi të planifikojë, të udhëheqë, të raportojë dhe të auditojë menaxhimin e sigurisë së informacionit në funksion të platformës që do të zhvillohet dhe mirëmbahet, si dhe të garantojë që sistemi është konform standardeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, në të gjithë hallkat funksionale të tij, duke mundur kështu menaxhimin në mënyrë të sigurt të informacionit. Prania e tij jep garanci për sigurinë e informacionit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

f) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për databazë.

Argumentim: Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë që Operatori Ekonomik ofertues është i aftë për administrimin e databazës aktuale dhe mirëmbajtjen eficiente të saj. Mënyra më e saktë dhe që paraqet më pak risk për konfirmimin e aftësive të stafit është pajisja me certifikata, dhe paraqitja e tyre si dëshmi kualifikimi. Prania e tyre jep garanci për implementimin e detyrave të kontratës bashkë me shërbimet e mirëmbajtjes 24 mujore dhe operimin e sigurt me elementët përbërës të databazës.

Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;
- CV
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 pjesa III, pika B.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike,

si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 41, pika 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duke qenë se projekti në vetëvete është një projekt TIK, nisur nga termat e referencës dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf të diplomuar/ certifikuar në degët/ fushat e sipërpërmendura, për të cilat kërkohet niveli i tyre profesional lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Objektivi i përgjithshëm i kontratës është të sigurojë: Përmirësime, riorganizime, integritet dhe zhvillime të reja të platformës zyrtare në çdo komponent të tij, me qëllim plotësimin e nevojave, kërkesave të institucionit dhe sigurimi i vazhdimësisë së punës mbi 99.9% në të gjithë komponentët dhe shërbimet e ofruara nga ky sistem.

Specifikimet teknike të këtij shërbimi, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Përmirësime, riorganizime, integritime e zhvillime të reja të platformës zyrtare në Institucion”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Termet e referencës/ specifikimet teknike*

NJËSIA E PROKURIMIT